



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor**

**Nr: 04-351/02-0019721/17**

**Dt. 03.03.2017**

**Prizren**

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesën e **Lulzim Shala** me banim në rrugën “ / ” në bazë të nenit 3 alineja 1 pika 7 e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor me nr.04L/174 të dt.31.07.2013, si dhe në nenin 3 alineja 1 pika 1.1, 1.4, 1.7, 1.10, 1.17, 1.20, 1.21. dhe të nenit 5 alineja 1 pika 1 si dhe nenit 14 alineja 1 pika 1 dhe në lidhje me nenin 15 alineja 1 pika 1 dhe nenit 19 alineja 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin e Planit Detal Urbanistik “Dardania” ish Jaglenica merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. U LEJOHET **Lulzim Shala** për lejimin e Ndërtimit të objektit – **Shtëpi individuale** në rrugën “**Azem Galica**” në lagjen “**Dardania**” , në ngastrën kadastrale: **1954-4** , të evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. **P-71813046-01954-4**, ZK Lubizhdë, me etazhitet **B+P+1** .
  - Sipërfaqja e përgjithshme nën dhe rreth godinës është **373 m<sup>2</sup>( sipas kopjes së planit)**
  - Sipërfaqja e përgjithshme bruto e objektit është **321.71 m<sup>2</sup>.**
  - Sipërfaqja e përgjithshme neto për njësi të reja banimi është **197.85m<sup>2</sup>.**
  - Tarifa për 1m<sup>2</sup> është **4.19 €** & tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës
  - Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **1690.40 €**
  - Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **92.623,20€.**
- II. Hartimin e projektit për objektin investiv nga pika I e këtij aktvendimi për të gjitha fazat e ka bërë kompania “**Diarko**”SH.P.K.. Prizren, dokumentacioni teknik është e tipit të **konform P.D.U.”Dardania” ish Jaglenica.**
- III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është situacioni i lokacionit me objekt sipas vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore të përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo Drejtori, i cili do të shërbejë si bazë për nivelimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij Aktvendimi.
- IV. Investuesi është i obliguar:
  - Që të ruajë një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit, është dhënë kjo leje ndërtimi;
  - Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;

- Të njoftoj Drejtorinë e inspeksionit për ditën e fillimit të punës, së paku 8 (tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të fiksimit dhe piketimit të shtrirjes së objektit brenda lokacionit.
- V. Investitori është i obliguar që 7 ditë pas përfundimit të objektit të paraqet kërkesën për kontrollimin teknik profesional te ky organ me qëllim të fillimit të procedurës për pajisje me Leje të përdorimit konform me nenin 49.50 dhe 51 të Ligjit për ndërtim nr. 2004/15  
Në rast se gjatë ndërtimit janë bërë ndryshime të projektit zbatues (gjatë realizimit të punimeve) investitori është i obliguar të prezantojë projektin e objektit në tërësi sipas zbatimit.
- VI. Leja e ndërtimit vlen 1 (një) vite nga dita e lëshimit me të drejtë vazhdimi edhe për një vit tjetër.
- VII. Punëkryesi është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte, ngase është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDC-it, Dukagjinit dhe avari tjera ti evitohet dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

## A r s y e t i m

**Parashtruesi i kërkesës: Lulzim Shala** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Azem Galica”** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të **objektit - shtëpi individuale** .

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se: që në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional të këtij organi.

Investitori s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura:  
- kopjen e planit; listën poseduese; aktvendimin mbi mbartjen e pronësisë me të cilët i ka zgjidhur marrëdhëniet pronëso-ro-juridike; kushtet urbanistike; pëlqimet e caktuara me kushte ndertimore si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave ma lartë të theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhanjen e leje se ndërtimit, si dhe të lirimit nga pagesa e komunaleve konform nenit 4. pika 6.1. paragrafi 4 të . Rregullores për taksa ,tarifa ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtarit komunale nr. 001/011-5452 dt. 31.03.2016.



**Udhëzimi juridik:** pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë s Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR


Hartuan

Bashkëpunëtorët profesional:

  
Xhejlane Gjini, inxh.dipl.ark.

  
Arben Shala, jur.dipl.

Kontrolloi:

  
Afërdita Mormorina, inxh.dipl.ark.

DREJTORI:

  
Visar Islamaj

